



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 058

HULUMTIMI NË VEPRIM

Tipi i programit: Themelor

Hyrje:

Programi i Arsimit Themelor (BEP) është program pesëvjeçar i cili financohet nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe implementohet nga FHI 360, me qëllim të ofrimit të përkrahjes për shkollat kosovare që të zhvillojnë shkathtësitë relevante të shekullit 21 të nxënësit.

Programi i Arsimit Themelor përbëhet prej tri komponentëve kryesorë:

1. Zhvillimi i kapacitetit të komunave dhe shkollave për udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave
2. Zhvillimin e kapaciteteve të shkollave për vlerësimin për të nxënë dhe
3. Përmirësimin e zhvillimit të mësimdhënësve pa shkëputje nga puna.

Komponenti i tretë për zhvillimin e mësimdhënësve implementohet në partneritet me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), e cila i koordinon aktivitetet në këtë komponentë me një qasje të integruar dhe në bashkëpunim të ngushtë me personelin teknik të Programit për Arsim Themelor.

Programi për Arsimin Themelor gjatë vitit 2011 ka zhvilluar një program koherent për zhvillimin profesional të mësimdhënësve pa shkëputje nga puna. Ky program dallon nga trajnimet e deritanishme për disa arsye. Së pari, për arsye sepse pjesa më e madhe e këtij programi zhvillohet me bazë në shkollë dhe ndërmerr një sërë masash për sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë:

1. Janë hartuar dhe miratuar Standardet e BEP për Fasilitimin e të Nxënës;
2. Është hartuar dhe miratuar Lista e Shkathtësive Prioritare e BEP;
3. Janë akredituar shtatë kurse për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, si dhe janë hartuar, testuar dhe përgatitur për akreditim edhe dy kurse tjera të kësaj komponente;
4. Janë zhvilluar kapacitetet për implementimin e këtyre kurseve (42 kryefasilitatorë dhe 73 fasilitatorë shkollorë);

5. Janë themeluar dhe pajisur Qendrat për Zhvillim Profesional (QZhP);
6. Janë shpërndarë pakot me pajisje teknologjike nëpër QZhP dhe shkolla për të mundësuar implementimin e këtyre kurseve.
7. Janë hartuar doracakët për kurset përkatëse për të ndihmuar informimin për qasjet e reja në mësimdhënie dhe të nxënë në shkollat kosovare.

Kurset për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë hartuar nga KEC-i në kuadër të jetësimit të këtij programi të BEP për zhvillimin profesional të mësimdhënësve kosovarë dhe janë në përputhje të plotë edhe me prioritetet dhe me objektivat strategjike të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit të MASHT (2011-2016) për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës është e përkushtuar ndaj ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes zhvillimit profesional të mësimdhënësve pa shpëputje nga puna. Deri tani, KEC ka zhvilluar dhe implementuar dhjetëra programe për aftësimin e mësimdhënësve vet dhe në bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë MASHT-in dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Kursi “ HULUMTIMI NË VEPRIM”

Kursi “Hulumtimi në veprim” është zhvilluar në kuadër të përpjekjeve të Programit për Arsimin Themelor për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Kursi është hartuar nga konsulentja Eda Vula dhe është diskutuar me kryefasilitatorët Afronë Lila dhe Rajmonda Kurshumlia.

Përshkrimi i kursit

Kursi “Hulumtimi në veprim” realizohet përmes tri ditëve të ndara punëtorie, ndërmjet të cilave është një periudhë së paku dy javore me ç rast mësimdhënësit veprojnë individualisht me hulumtimin e tyre në veprim. Pas punëtorisë së parë në të cilën mësimdhënësit marrin njohuri për hulumtimin në veprim, ata kanë dy javë periudhë kohore për të kryer punë rreth hulumtimit të tyre në shkollë. Pastaj, mësimdhënësit mbajnë takimin e parë reflektues, të përkrahur nga fasilitatorët dhe kolegët e tyre. Mësimdhënësit vazhdojnë punë individuale edhe dy javë të tjera, dhe takohen në ditën e dytë të punëtorisë, ku prezantohet pjesa e punës së kryer deri në këtë fazë. Pastaj vazhdojnë me punë individuale (hulumtimin e tyre në shkollë) edhe dy javë tjera, i cili prapë rezulton me një takim të dytë reflektues. Në fund, mësimdhënësit mbajnë ditën e tretë të punëtorisë, me ç’rast prezantohen punimet dhe fasilitatorët e kolegët japin informata kthyesë. Procesi përfundin me raportin final të hulumtimit në veprim, i cili mund të publikohet në platforma edukative, si shembull për mësimdhënësit tjerë në sistem.

Qëllimet e kursit:

- Kuptimi i rolit të mësimdhënësit si hulumtues në klasën/shkollën e tyre;
- Aftësimi i mësimdhënësve për të shqyrtuar në mënyrë kritike situatat problemore në klasë/shkollë;
- Përmirësimi i praktikave profesionale përmes hulumtimeve në klasë/shkollë;
- Sigurimi i 'shembujve' të mirë dhe reflektim kritik për to;
- Shfrytëzimi i hulumtimeve në veprim si një burim për hulumtimet e mëtutjeshme në fushën e arsimit.
- Përmirësimi i praktikave të mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve

Rezultatet e të nxënit

Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje të:

- identifikojnë situata/probleme të lidhura me mësimdhënien, të nxënit dhe arsimin në përgjithësi;
- shqyrtojnë literaturë profesionale dhe shkencore në lidhje me çështjet arsimore;
- demonstrojnë aftësi për planifikimin dhe zhvillimin e një cikli të hulumtimit në klasë/shkollë;
- reflektojnë rreth praktikës së tyre profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm dhe në interes të përmirësimit të rezultateve të nxënësve në klasë/shkollë.
- analizojnë lidhjet në mes të teorisë dhe praktikës në fushën e arsimit duke vendosur hulumtimin në klasë/shkollë në një kontekst të ndërvarur;
- zhvillojnë projekte të hulumtimit në klasë apo shkollën ku punojnë dhe të shkruajnë raportin e atij hulumtimi;
- bashkëpunojnë me 'miqtë kritik' për të reflektuar për vlefshmërinë e hulumtimeve në klasat e tyre.

Implementimi i kursit (metoda, forma, dhe vendi):

Kursi "Hulumtimi në veprim" do të zbatohet në tri forma/ faza:

1. Punëtoritë (18 orë)

Punëtoritë fasilitohen nga 2-3 fasilitatorë të aftësuar dhe certifikuar nga Programi për Arsimin Themelor (BEP) i USAID-it, komponenti i zhvillimit profesional të mësimdhënësve, i implementuar nga KEC. Secila punëtori ka nga katër sesione pune 90 minutëshe.

2. Aktivitetet në shkollë - punë hulumtuese individuale e mësimdhënësve

Përmbajtja e kursit do të zbatohet nga të gjithë mësimdhënësit e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët, të përkrahur nga fasilitatorët dhe 'miqtë kritik'. Aktivitetet në shkollë organizohen në dy periudha. Cikli i parë i hulumtimit në veprim zhvillohet pas punëtorisë së parë. Në këtë fazë, mësimdhënësit fillojnë me realizimin e planeve të veprimit dhe mbledhjen e të dhënave të hulumtimeve të tyre. Faza e dytë e punës së mësimdhënësve realizohet pas punëtorisë së dytë me qëllim të analizës së të dhënave dhe rishikimit të planeve të veprimit. Poashtu, në këtë fazë, mësimdhënësit shkruajnë raportet e hulumtimeve të tyre.

3. Takimet reflektuese / konsultimet me fasilitatorë (6 orë)

Për të mbështetur mësimdhënësit gjatë punës së tyre hulumtuese, organizohen dy takime reflektuese me pjesëmarrësit. Fasilitatorët takohen individualisht ose në grupe me mësimdhënësit për të diskutuar fazat e realizimit të projekteve hulumtuese në klasat apo shkollën e tyre. Takimi i parë realizohet ndërmjet punëtorisë së parë dhe të dytë, kurse takimi i dytë, ndërmjet punëtorisë së dytë dhe të tretë.

Informata mbi planifikimin e mëtutjeshëm

Numri i synuar i mësimdhënësve të trajnuar për vitin 2012/13 është 50. Në fazën testuese janë trajnuar gjithsej 18 mësimdhënës nga shkollat e përzgjedhura dhe hulumtimet në veprim të kryera nga këta mësimdhënës janë përgatitur për publikim në ueb faqen e Programit BEP të USAID-it.

Mësimdhënësit do të inkurajohen të shfrytëzojnë hulumtimin në veprim si pjesë e integruar e mësimdhënies së tyre. Hulumtimet e realizuara në klasë duhet të jenë në përputhje me parimet e Kornizës së Kurrikulës të Kosovës dhe me shkathtësitë relevante të BEP-it.

Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licencim

Kursi: 24 orë të llogaritura për licencim

Aktivitetet me bazë në shkollë: numër i caktuar i orëve të licencimit për çdo aktivitet të mbajtur me sukses (gjithsej 18+6 orë të llogaritura për licencim-shih në vijim):

Për implementimin të kursit “Hulumtimi në veprim” janë caktuar aktivitetet në vijim:

1. Organizimi i së paku një projekti hulumtues në periudhën për 8 javë.
2. Shkrimi i raportit/ve të hulumtimit të realizuar
3. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i kolegëve për prezantimin e raportit të hulumtimit.

Programi ka gjithsej 24 orë.

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e punëtorive mbi 90%, vlerësimi pozitiv i raportit të hulumtimit nga fasilitatorët, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i kolegëve për prezantimin e raportit të hulumtimit.